

THIRRJE PËR APLIKIM PËR GRANTE

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur fton organizatat jo-qeveritare të Kosovës të aplikojnë me projekt propozime për programet: ankorimi i institucioneve në standarde evropiane; arsim; dhe transparencë e llogaridhënie.

1. Qëllimi i thirrjes për propozime

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) është i përqëndruar në disa fusha kryesore të cilat përfshijnë edhe (i) ankorimin e institucioneve kosovare në standardet e BE-së; (ii) depolitizimin dhe reformimin e sistemit të edukimit në Kosovë, dhe (iii) rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucione publike.

Për t'i arritur këto objektiva, Fondacioni përkrahë financiarisht organizata të shoqërisë civile për të implementuar projekte hulumtuese dhe avokuese që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me qëllimet më të ngushta të secilit program. Për më tepër, Fondacioni mbështetë organizatat me trajnime dhe punëtori në mënyrë që t'i ngrisë kapacitetet e tyre për avokim, përfshirje në vendimmarrje dhe rritjen e transparencës në të gjitha sektoret.

Me këtë thirrje, Fondacioni fton **të gjitha organizatat jo-qeveritare**, të cilat përmbushin kushtet dhe propozimet e të cilave janë në linjë me prioritetet e poshtë-shënuara, të aplikojnë për mbështetje me grante deri me **15 shtator 2020**.

2. Fushat programore me prioritet

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur fton organizatat që të aplikojnë me projekt propozime në tri fusha programore:

- a) Programi i ankorimit në standarde evropiane dhe bashkëpunim rajonal
- b) Programi i edukimit
- c) Programi i transparencës dhe llogaridhënies

Në fushën e **ankorimit të institucioneve në standarde evropiane dhe bashkëpunim rajonal** do të merren parasysh projektet që përfshijnë:

- a. Hulumentim dhe avokim në zbatimin e agjendës së reformave evropiane dhe bashkëpunimin me BE-në;
- b. Avokim për praktika më të mira dhe me standard evropiane në adresimin e pandemisë Covid-19, duke përfshirë fushat si mirëqenia sociale, shëndetësia publike, dhe rimëkëmbja ekonomike;
- c. Avokim për pjesëmarrje më të gjërë të shoqërisë civile në vendimmarrje për politika publike;
- d. Hulumentim dhe avokim për iniciativa ndër-rajonale të bashkëpunimit në përballjen e pandemisë, rimëkëmbjen ekonomike të rajonit dhe integrimet evropiane; dhe
- e. Hulumentim dhe avokim për gjithpërfshirje dhe rritje të transparencës në procesin e dialogimit mes Kosovës dhe Sërbisë

Në fushën e **Edukimi** do të inkurajohen projektet që merren me:

- a. Mbikëqyrjen e transparencës së proceseve mësimore, akademike dhe menaxhimit të financave, përfshirë ehe atë gjatë situatës së covid19
- b. Menaxhimin e situatës dhe planifikimi për të ardhmen: 1. Analizimi i menaxhimit të situatës, sfidave dhe planeve të emergjencave për arsimin e lartë 2. Analizimi i planifikimeve afatmesme të institucioneve relevante për arsimin e lartë
- c. Ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet e edukimit të lartë, e cila mund të përfshijë, por jo kufizuar tek, analizat dhe hulumtimet

Në fushën e **transparencës dhe llogaridhënies në institucione publike** do të merren parasysh projektet që përfshijnë:

- a. Transparencë dhe efikasitet në implementimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike të qeverisë
- b. Avokim për përfshirjen e grupeve të marginalizuara në pakon e rimëkëmbjes ekonomike
- c. Degradim i ambientit si pasojë e aktiviteteve të ndryshme biznesore dhe investimeve kapitale
- d. Monitorim i aktiviteteve të prokurimit në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit gjatë pandemisë Covid-19

3. E drejta për aplikim

Aplikantët të cilët kanë të drejtë të aplikimit janë të gjitha **organizatat joqeveritare** në të regjistruara sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Aplikantët duhet të cekin statusin e organizatës (shoqatë, fondacion, apo institut) dhe duhet të përfshijnë emrat e të gjithë anëtarëve të strukturës organizative.

Aplikantët të cilët përjashtohen nga kjo ftesë për aplikime janë:

- Individëti;
- Partitë politike; dhe
- Organizatat të cilat synojnë financimin e aktiviteteve fetare.

Fondacioni mban të drejtën të diskualifikojë nga ky konkurs organizatat të cilat kanë struktura menagjeriale të paqarta, apo që nuk kanë ndarje të qartë në mes të organeve vendimmarrëse dhe mbikqyrëse dhe stafit implementues të projekteve.

4. Udhëzime për aplikim

Për të aplikuar, organizatat duhet të dërgojnë:

- 1) Formën e plotësuar për aplikim për grante
- 2) Formën e plotësuar të deklaramit të konfliktit të interes
- 3) CV-të e stafit implementues të projektit (dhe të konsulentëve të jashtëm nëse parashihen të tillë)
- 4) Kopjen e çertifikatës së regjistrimit të organizatës
- 5) Pasqyrat financiare të vitit të fundit
- 6) Vërtetimi nga ATK për obligimet tatimore (pranohet edhe forma on-line e vërtetimit)
- 7) Raporti i auditorit nëse kërkohet sipas ligjit
- 8) Portfolio i punës së organizatës

Të gjitha format mund të shkarkohen nga uebsajti i KFOS [këtu](#).

Të gjitha dokumentet duhet të dërgohen me email te konkursi@kfos.org duke shënuar në subjektin e emailit që jeni duke iu përgjigjur thirrjes së hapur.

Informatat në lidhje me projektin, qëllimet dhe aktivitetet duhet të jenë koncize dhe t'i përmbahen udhëzimeve të gjatësisë në formën e aplikimit. Aplikantët duhet të prezantojnë idete e tyre qartë duke i ndërlidhur qëllimet e projektit me aktivitete dhe rezultate. Aplikantët duhet të prezantojnë rezultate konkrete të pritshme dhe të shpjegojnë ndikimin dhe rëndësinë e projektit.

5. Afati i dorëzimit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **15 shtator 2020**. Aplikacionet duhet të dorëzohen **me email** tek konkursi@kfos.org.

Pyetje në lidhje me procesin e aplikimit mund të dërgohen tek info@kfos.org.

6. Përzgjedhja e grantistëve

Aplikacionet që dorëzohen brenda afatit të dorëzimit dhe përmbushin të drejtën e aplikimit, dhe kriteret administrative, do të shqyrtohen nga Fondacioni.

6.1. Kriteret administrative

- E drejta për aplikim (shih 3)
- Formulari për aplikim i plotësuar
- Dorëzimi i të gjitha dokumenteve përcjellëse (shih pikën 4)

6.2. Kriteret për vlerësim

Fondacioni do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet që përmbushin kriteret, duke i vlerësuar ato në bazë të:

- Relevancës së projektit: projekti i përshtatet fushave dhe prioritetëve të paracaktuara në thirrje
- Kapaciteti i aplikantit për të implementuar në plotni projektin e propozuar,
- Grupet e synuara: projekt propozimi identifikon grupe të qarta të interesit dhe parasheh diversitetin e tyre,
- Aktivitetet: projekti parasheh aktivitete që ndërlidhen qartë me qëllimet e projektit dhe kanë ndikim te grupet e synuara,
- Plani i avokimit: projekt propozimi parasheh një plan të qartë për të avokuar tek institucionet përkatëse në lidhje me qëllimin e projektit,
- Indikatorët: projekti parasheh rezultate të prekshme,
- Buxheti: buxheti është i planifikuar mirë dhe reflekton aktivitetet e projektit.

7. Kohëzgjatja e granteve

Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë jo më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se 9 muaj. Projektet mund të planifikohen të fillojnë prej fillimit të tetorit deri në fund të nëntorit 2020.